



“Instituti për Zhvillim
& Inisiativa Qytetare”



TË DREJTAT PRONËSORE TË GRAVE NË VERI TË SHQIPËRISË

KANUNI VS LIGJI

DORACAK INFORMUES

Ky doracak është botuar në kuadër të projektit “Fuqizimi i grave dhe vajzave në Malsinë e Madhe & Shkodër për të drejtat pronësore”, zbatuar nga Instituti për Zhvillim dhe Inisiativa Qytetare me mbështetjen financiare të Mediterranean Women’s Fund.

Përmbajtja e këtij doracaku është përgjegjësi e vetme e IZHIQ dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Mediterranean Women’s Fund.

Shtator 2023

Përmbajtja

E DREJTA PRONËSORE	6
Çfarë është 'e drejta pronësore'?	6
Mënyrat e fitimit të pronësisë	7
REGJIMI PASUROR MARTESOR	8
Regjim i bashkësisë ligjore	10
Regjimi i bashkësisë me kontratë	10
Regjimi i pasurive të ndara	10
Bashkësia Ligjore	11
PRONËSITË QË FITOHEN GJATË MARTESËS,POR JANË NË PRONËSI TË VETËM NJËRIT BASHKËSHORT	11
FITIMI I PRONËSISË ME ANË TË TRASHËGIMISË	12
Si fitohet prona me trashëgimi?	12
Çfarë të drejtash kam si trashëgimtare?	12

Përmbajtja

E DREJTA ZAKONORE PËR REGJIMET PASURORE MARTESORE **13**

Ka apo nuk ka të drejtë një grua të marrë pjesë në trashëgiminë e prindërve apo të burrit? Ligji vs Kanuni **13**

Si rregullohej zgjidhja e martesës sipas Kanunit? **14**

KANUNI I LEKË DUKAGJINIT (KLD) **15**

KANUNI I LABËRISË **17**

ÇFARË TË DREJTE KANË GRATË MBI PASURINË E PALUAJTSHME TOKË BUJQËSORE? **19**

Ligjin nr. 7501/19.07.1991 “Për tokën”? **19**

E DREJTA PRONËSORE E GRAVE SIPAS INSTRUMENTAVE NDËRKOMBËTARE **22**

Përmbajtja

PSE DUHET T'I NJOHIN GRATË INSTRUMENTAT NDËRKOMBËTARE?	23
DEKLARATA UNIVERSALE E TË DREJTAVE TË NJERIUT	24
KONVENTA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT (KEDNJ)	25
KONVENTA PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT NDAJ GRAVE [CEDAW], RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 1769/1993	26
KARTA E TË DREJTAVE THEMELORE E BASHKIMIT EVROPIAN	27

E DREJTA PRONËSORE

Çfarë është 'e drejta pronësore'?

E drejta pronësore është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, pronën që të përket, brenda kufijve të caktuar nga ligji”.

Të gëzosh sendin apo pronën do të thotë ta përdorësh dhe ta shfrytëzosh vetë atë, ose ta japësh në përdorim të të tjerëve. Prona mund t’u jepet të tjerëve me qera me qëllimin për të nxjerrë të ardhura, ose me huapërdorje..

Të disponosh pronën do të thotë që të kesh të drejtë të përcaktosh “fatin” e sendit/pasurisë. Pra nëse ju jeni pronare e një pasurie, keni të drejtë që të kryeni veprime juridike të ndryshme si shitje, shkëmbim, ta vendosni në hipotekë, madje mund të hiqni dorë nga një e drejtë që keni mbi të.



Pronësia është një institut juridik me rëndësi ekonomike, shoqërore dhe politike. Ajo përveçse një marrëdhënie shoqërore është edhe një marrëdhënie juridike civile pasurore[1]. Pronari sillet me sendin e tij në mënyrën e tij, duke përjashtuar individët e tjerë, që ndërhyjnë në sjelljen e tij, përderisa kjo sjellje nuk është në kundërshtim me ligjin dhe me të drejtat e të tjerëve[2].

[1] Nuni A., Hasaneziri L., (2008), Leksione të pronësisë dhe trashëgimisë, Tiranë.

[2] Gjata, R., (2010) E drejta civile, Tirane, ALBPaper, fq. 42

Nocioni i pronësisë para së gjithash është shprehje e asetit ekonomik, për arsye se, thelbi i saj, është vlerësimi i të mirave materiale nga personi i caktuar. Çdonjeri është zotërues i drejtpërdrejtë i lirisë dhe i të drejtave të tij, që në çastin që krijohet si qenie. Të drejtat e njeriut janë parime themelore, pa të cilat njerëzit s'mund të jetojnë si qenie njerëzore me dinjitet. Respektimi i tyre bën të mundur progresin e plotë të individit dhe të shoqërisë.

Mënyrat e fitimit të pronësisë:

Të drejtat pronësore fitohen përmes:

- Dhurimit
- Trashëgimisë
- Blerjes së pronës
- Martesës

Kodi Civil parashikon më gjerësisht mënyrat e fitimit të pronës. Të drejta pronësore fitohen edhe për shkak të martesës.





Pra, nëse jeni martuar dhe keni zgjedhur regjimin e “bashkësisë ligjore”, çdo pasuri e fituar gjatë martesës, nëse nuk është vetjake e bashkëshortit, bëhet pasuri e përbashkët, e juaja dhe e bashkëshortit. Kjo nuk ka të bëjë me faktin nëse punoni ose jo, keni marrë pjesë në lidhjen e kontratës ose jo. Në çdo rast, ju jeni bashkëpronare e kësaj pasurie.

REGJIMI PASUROR MARTESOR

Martesa përfaqëson një bashkim juridik ndërmjet dy personave të gjinive të ndryshme, të cilët synojnë një jetesë të përbashkët si edhe realizimin e interesave personale dhe pasurore, duke formuar kështu një bashkësi në drejtim të kontributit dhe mbarëvajtjes së familjes.[1]

Me regjim pasuror martesor nënkuptojnë tërësinë e normave dhe rregullave juridike që përcaktojnë mënyrën e gëzimit, administrimit dhe disponimit të pasurisë bashkëshortore. Të drejtat, detyrimet dhe tagrat që kanë bashkëshortët kundrejt pasurive vetjake apo të bashkësisë sipas llojit të regjimit.

Gjatë jetesës së përbashkët, bashkëshortët fitojnë të ardhura ose mund të bëhen titullarë të të mirave pasurore, të ardhura dhe pasuri të cilat në raportet bashkëshortore i nënshtrohen regjimeve specifike pasurore në raport me format e tjera të bashkëpronësisë.



[1] Sonila OMARI – E drejta familjare, botimet Morava, Tiranë 2012.

Regjimet pasurore martesore, për vetë rëndësinë që paraqesin, trajtohen me hollësi nga kodi i familjes.

Në Kodin e Familjes parashikohet se kemi tre regjime pasurore martesore:

- Regjimi pasuror martesor në bashkësi,
- bashkësia me kontratë
- dhe regjimi i pasurive tëndara.

Regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore zbatohet kur bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë për regjim tjetër pasuror martesor .

Ligji ka parashikuar se regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore aplikohet menjëherë pas lidhjes së martesës nëse vërtetohet se mes bashkëshortëve nuk kemi lidhjen e një kontrate martesore për rregullimin e marrëdhënieve pasurore mes tyre. Gjithashtu, kodi i familjes shkon më tej duke përcaktuar edhe përbërjen e bashkësisë ligjore.



1 Regjim i bashkësisë ligjore:

Është një nga llojet e regjimeve martesore, i cili zbatohet automatikisht në qoftë se bashkëshortët nuk kanë zgjedhur ndonjë regjim të caktuar martesor dhe ku janë parashikuar detyrime të caktuara prej bashkëshortëve në lidhje me sendet që përbëjnë pasurinë bashkëshortore dhe që janë të nevojshme për funksionimin e familjes nga ana ekonomike.

2 Regjimi i bashkësisë me kontratë:

Në bazë të këtij regjimi me anë të kontratës të nënshkruar para noterit, para lidhjes së martesës, bashkëshortët vendosin për mënyrën sesi do të gëzojnë dhe administrojnë apo disponojnë analizë e standardeve ligjore dhe e zbatimit të tyre në praktikë 25 sendet e vëna gjatë martesës, ku këto të drejta mbi sendet mund të jenë të barabarta, ose më të mëdha në favor të njërit ose tjetrit bashkëshort, sipas vullnetit të bashkëshortëve.

3 Regjimi i pasurive të ndara:

Sipas këtij regjimi në lidhje me bashkëpronësinë ndërmjet bashkëshortëve zbatohen rregullat e bashkëpronësisë në pjesë, ku çdo pasuri e vënë nga njëri bashkëshort gjatë martesës, është pasuri vetëm e tij, me përjashtim të sendeve që janë të nevojshme për mbajtjen e familjes.

Bashkësia Ligjore përbëhet nga:

- Pasuria e fituar nga të dy bashkëshortet, së bashku ose veç e veç gjatë martesës.
- Të ardhurat nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkëshorti gjatë martesës, nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë.
- Frytet e pasurisë së çdo bashkëshorti, të cilat nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë
- Veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës

PRONËSITË QË FITOHEN GJATË MARTESËS, POR JANË NË PRONËSI TË VETËM NJËRIT BASHKËSHORT

- pasuritë e fituara me trashëgim;
- pasuritë e fituara me dhurim;
- pasuritë e përfitimit ngushtësisht vetjak;
- mjetet e nevojshme të punës për ushtrimin e profesionit;
- pasuria e fituar nga shpërblimi i dëmit vetjak;
- pasuria e fituar nga tjetërsimi i pasurive vetjake;
- shkëmbimi i tyre, kur kjo është deklaruar shprehimisht në aktin e blerjes.

FITIMI I PRONËSISË ME ANË TË TRASHËGIMISË

Si fitohet prona me trashëgimi?

Trashëgimia ka një rol dhe vend të veçantë në statusin pronësor të gruas. Një grua bëhet pronare kryesisht, për shkak të bashkëpronësisë bashkëshortore ose trashëgimisë nga familja e origjinës, ose nga bashkeshorti pas vdekjes së tij. Që prona të fitohet me trashëgimi duhet të ketë vdekur personi që lë pasuri në trashëgim dhe ju të jeni në rrethin e trashëgimtarëve. Trashëgimia fitohet me ligj ose me testament. Rregullat përcaktohen në Kodin Civil. Trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka bërë testament.



Çfarë të drejtash kam si trashëgimtare?

Nëse jeni në rrethin e trashëgimtarëve ju përfitoni të drejta mbi këtë pasuri si gjithë trashëgimtarët e tjerë. Pra, nëse trashëgimlënësi ka vdekur në vitin 1970, rrethi i trashëgimtarëve do të përcaktohen sipas ligjit që ka qenë në fuqi në vitin 1970.



KUJDES!

Trashëgimia çelet vetëm kur vdes trashëgimlënësi. Praktika tregon se grave u kërkohet që të nënshkruajnë një marrëveshje përmes të cilës ato shprehen për mënyrën se si do të përdoren të drejtat që rrjedhin nga një trashëgimi ende e paçelur. Kjo marrëveshje është e pavlefshme. Pra, edhe nëse keni nënshkruar diçka të tillë, kjo nuk ka asnjë vlerë juridike detyruese.

E DREJTA ZAKONORE PËR REGJIMET PASURORE MARTESORE



Ka apo nuk ka të drejtë një grua të marrë pjesë në trashëgiminë e prindërve apo të burrit?

Ligji vs Kanuni

Zakonet e trashëgimisë në Shqipëri, ende favorizojnë në masë të madhe pasardhësin mashkullin në raport me pasardhëset femra. Pas vdekjes së babait apo bashkëshortit, vajza/gruaja është shpesh në rrezik për mos marrjen e pjesës së saj të ligjshme të pasurisë, përshirë pasurinë e paluajtshme.

Në kuadër të zakoneve në Shqipëri, të përcaktuara me rregullat tradicionale si Kanuni i Lekë Dukagjinit apo edhe Kanunet e tjera, gratë janë përjashtuar nga trashëgimia familjare pasi prona ka ndjekur vijën mashkullore.

Po të shfletojnë kanunin e Lekë Dukagjinit hasemi me “Tagrin e Trashigimit”, në nyjen e 36-të thuhet:

88. “Kanuja njef për trashëgues djalin e jo vajzen ”.

91. “As te prindja as te burri gruaja s’hin në pjesë të trashigimit ”.

Mirëqënia e një individi është e lidhur ngushtë me respektimin e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Në këtë kuadër e drejta për pronë, është një e drejtë themelore dhe e patjetërsueshme e çdo individi. Edrejta pronësore fitohet në 3 mënyra kryesore: dhurimit, trashëgimisë si dhe blerjes së pronës.

Sipas ligjit një grua bëhet pronare kryesisht, për shkak të bashkëpronësisë bashkëshortore ose trashëgimisë nga familja e origjinës, ose nga bashkëshorti pas vdekjes së tij.

Sipas së drejtës trashëgimore një grua ka të drejta mbi pasuri si të gjithë trashëgimtarët e tjerë nëse ajo është në rrethin e trashëgimtarëve.

Trashëgimia fitohet me ligj ose me testament. Rregullat përcaktohen në Kodin Civil. Trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka bërë testament.



Pra, nëse trashëgimlënësi ka vdekur në vitin 1970, rrethi i trashëgimtarëve do të përcaktohen sipas ligjit që ka qenë në fuqi në vitin 1970.

Si rregullohej zgjidhja e martesës sipas Kanunit?

Zgjidhja e martesës krijonte disa probleme juridike ndërmjet palëve për rritjen e fëmijëve, si dhe për pasurinë që gruas i takonte të mernte në shtëpinë bashkëshortore. Duke u mbështetur fort në mendësinë patriarkale, e drejta zakonore shqiptare i kishte zgjidhur thjesht këto dy probleme të mëdha në dobi të burrit[1].

Gruas nuk i njihej asnjë pjesë në pasurinë e përbashkët të familjes, asnjë kontribut, si në pasurinë e luajtshme ashtu edhe në atë të paluajtshme[2].


Si rregull, gruaja mernte me vete vetëm teshat e shtatit (Kanuni i Mirditës, v.p., neni 314).

Gruaja pa fëmijë mernte edhe teshat e arkës si dhe ato që kishte punuar vetë. Gruaja me fëmijë mernte vetëm teshat e shtatit; ato të arkës u mbeteshin fëmijëve; shtresat e mbulesat, burrit (Kanuni i Lumës, v.p., neni 829-831).

[1] Aleks Luarasi, 2001, fq. 199

[2] Aleks Luarasi, 2001, fq. 200

KANUNI I LEKË DUKAGJINIT (KLD)



Sipas kanunit të Lekë Dukagjinit, gruaja “asht shakull per me bajtë” (Gjeçovi O.F.M Shtefën, Kanuni i Lekë Dukagjinit, fq. 19). Ajo ishte vetëm një punëtore dhe kishte për detyrë të punonte si, në derë të babait ashtu edhe, në derë të burrit. Njëkohësisht, sipas kanunit ajo konsiderohej një gjë e tepërt në shtëpi. Për gjithçka, duke menduar mbi të gjitha për martesën e saj, prindërit e vajzës nuk kishin asnjë lloj detyrimi për të menduar për pajën e saj pasi këtë detyrim e kishin prindërit e djalit që do ta merrnin në shtëpi.

Sipas KLD gruaja ishte një qenie inferiore, pronë e burrit, i cili ishte “kreu i shtëpisë” (Begeja Ksanthipi, 1984, fq. 33).

Kjo ishte pozita shoqërore që i ishte atribuar. Duke marrë shkas nga kjo pozitë, lehtësisht mund të kuptohet pozita e saj edhe në shtëpinë e burrit. Ajo duhet të ishte nën urdhrat dhe duhej të sillej ashtu siç i duhej burrit të saj (KLD, fq. 20). Ajo nuk kishte asnjë të drejtë, as mbi fëmijët e as mbi shtëpinë. Gjithashtu gruaja nuk gëzonte të drejta trashëgimore mbi pasurinë e lënë nga prindi apo nga burri (KLD, fq. 26).

Arsyet e ndarjes mund të ishin shkelja e besnikërisë bashkëshortore dhe marrja më qafë ose pabesia që gruaja mund të tregonte ndaj mikut që vinte në shtëpi. Në këtë rast, ajo vritej nga i shoqi (KLD, fq. 20). Për vjedhje (hajdutllik) ai thjesht e ndante dhe me kanun nuk kishte të drejtë të ushtronte asnjë dhunë mbi të. Por në këtë rast, kur ai e lëshonte gruan, kjo e fundit nuk merrte asnjë send me vete përveç teshave që kishte të veshura në ato çaste (KLD, fq. 20).




Në rastin kur gruaja mbetej e ve dhe akoma nuk kishte bërë asnjë fëmijë, ajo duhej të largohej nga dera e burrit dhe merrte me vete “petkat, qi pat pru si nuse e arkën me dry i merr me vedi” (KLD, fq. 20). Kjo tregon se gruaja nuk kishte asnjë të drejtë pasurore mbi atë që fitohej gjatë martesës. Madje, ajo nuk mund të merrte me vete as të gjitha gjërat që mund të kishte sjellë me pajë përveç sendeve të treguara në kanun. Por, në rast rimartese të saj, ajo nuk merrte asgjë nga pasuria sepse sipas kanunit “Toka e burrit të parë s’qet bimë ma për të” (KLD, fq. 20).[1]

[1] PranveraXhafaj-Regjimetpasuroremartesore.pdf

KANUNI I LABËRISË

Në Kanunin e Labërisë do të shikojmë një pozitë jo të barabartë të gruas me burrin siç ndodhte dhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit. Duke filluar nga vlera që i jepej gjakut të saj ku ajo do të barazohet me gjysmën e vlerës së gjakut të burrit (Kan. Labërisë, fq. 39) e duke vazhduar edhe në marrëdhëniet familjare, martesore, ekonomike e shoqërore ku burri do të gëzonte më shumë privilegje ndaj gruas (Kan. Labërisë, fq. 39).



Sipas Kanunit të Labërisë, ajo nuk mund ta merrte fëmijën pasi ai ishte i burrit, nuk kishte asnjë të drejtë të trashëgonte as te babai as te burri dhe në asnjë mënyrë ajo nuk merrte pjesë në shitblerjet e pronave (Kan. Labërisë, fq. 39).

Gruaja kishte të drejtë për të kërkuar ndarjen, dhe këtë vetëm në marrëveshje me babanë e saj, në rastet e shkeljes së kurorës nga burri ose kur ai kishte tentuar ta vriste apo kur kishte të meta fizike/psikike (Kan. Labërisë, fq. 123). Në këtë këndvështrim, këtu nuk shohim të njëjtin shtrëngim si te Kanuni i Lekës.

Në të njëjtën kohë, shohim një farë “lirimi” të të drejtave të gruas përsa i përket dhuratave të nusërisë pasi në Kanunin e Labërisë gruaja e martuar i kishte në pronësinë e vet të gjitha ato, në ndryshim nga Kanuni i Lekë Dukagjinit. Por në të njëjtën kohë edhe pasuria e tyre bashkëshortore ishte në duart e burrit me përjashtim të dhuratave të mësipërme.



Këtu shohim që të dy janë përgjegjës për ruajtjen, zhvillimin dhe shtimin e kësaj pasurie. Por, administrimi i saj mbetet gjithmonë në tagrin e burrit (Kan. Labërisë, fq. 122).



Gruaja e ndarë, me ose pa fëmijë, merrte rrobat e trupit, ndonëse ato ishin blerë nga burri, pajën e sjellë me vete, si dhe dhuratat që i ishin bërë para ose pas martesës.

Ajo kishte të drejtë, gjithashtu, të merrte prej burrit 60 okë misër për tre muaj, sipas sharteve të Idriz Sulit (Luarasi Aleks, cit., fq. 200).



Çfarë të drejte kanë gratë mbi pasurinë e paluajtshme tokë bujqësore?


Ligjin nr. 7501/19.07.1991 "Për tokën"?

Pasuria e paluajtshme, tokë bujqësore, u nda në bazë të ligjit 7501 "Për Tokën", për frymë, familjeve që banonin në zonat rurale dhe ishin anëtarë të familjes, sipas certifikatës së gjendjes civile të 01 Gushtit 1991 (për pasuritë kooperativë bujqësore) dhe të certifikatës së gjendjes civile të datës 01 Tetor 1992 (për pasuritë që ishin ferma bujqësore).

Në familjen bujqësore, mund të hyjnë anëtarë të rinj (me anë të martesës, lindjes, birësimit), por edhe mund të dalin anëtarë nga familja bujqësore, pra të largohen.

Toka është regjistruar në emër të kryefamiljarit, por pronësinë mbi të e përfitojnë të gjithë anëtarët, të cilët janë në përbërjen familjare sipas certifikatës së gjendjes civile aktuale. Në rast se anëtarët do ta tjetërsojnë pasurinë e paluajtshme (shesin, dhurojnë, pjesëtojnë apo shkëmbejnë), duhet të nënshkruajnë vetëm anëtarët të cilët janë në përbërjen familjare aktuale (vërtetuar me certifikatë familjare) të kryetarit të familjes bujqësore që ka emrin në certifikatën e pronësisë. Bashkëshortja e kryefamiljarit përfiton në pjesë tëbarabartë me anëtarët e tjerë të familjes bujqësore. I gjithë ky arsyetim është i bazuar në ligjin "Për Tokën" .

Ligji de jure parashikon se toka është e regjistruar në emër të familjarit, por pronësia mbi këtë tokë (pasuri e paluajtshme) përfitohet nga gruaja dhe të gjithë antarët e familjes në mënyrë të barabartë.



Por de facto nuk ndodh kjo gjë, toka nuk është ndarë në mënyrë të barabartë madje e përjashtonte gruan.

Sipas të drejtës zakonore (ku zanafillën e ka nga Kanunet), qytetarët vendosën vetë për ndarjen e tokës duke respektuar kufijtë e vjetër që kishin pasur në pronësi paraardhësit e tyre.

Komisioni i ndarjes së tokës bujqësore, duke u bazuar në vullnetin e banorëve të këtyre zonave (duke mos hasur në kundërshtime apo pretendim nga palë të treta), nuk u bazua në ligjin e kohës.

Të gjithë banorët e zonës u pajisën me AMTP (aktin marrjes së tokës në përdorim/pronësi) mbi bazën e sipërfaqeve, që në shumë raste ishte më e madhe se numri i anëtarëve, fakt i cili nuk u pasua me ndonjë kontestim ligjor nga ana e banorëve apo institucioneve publike.


Kjo procedurë, vijoi të ishte e njëjtë edhe në vitet në vijim.

Ndarja e tokës sipas kësaj mënyre, përveç problemeve juridike (të cilat i evidentojmë sot), duket se solli edhe një problem të thelluar social, i cili lidhej me 'përjashtimin' nga e drejta e pronësisë/bashkëpronësisë e grave të familjes.

AMTP-të, në pothuajse 100% të rasteve janë ndarë në emër të kryefamiljarit, i cili ishte mashkulli i shtëpisë (gjyshi, bashkëshorti, babai, vëllai). Pasuria, edhe pse është në posedim të grave (vetëm grave të martuara, vajzat posedojnë tek burri), ajo nuk kalon në pronësi të saj, kryesisht për shkak të mentalitetit patriarkal sipas të cilit:

"Pasuria i përket dhe trashëgohet vetëm në vijë mashkullore". Sipas së drejtës zakonore është bërë diskriminim i theksuar i grave në të drejtën pronësore, sipas kësaj të drejtë që bazohet tek kanunet.

Kështu ka ndodhur për breza me radhë dhe kështu do të vijojë edhe për brezat e ardhshëm. Gratë përfitojnë për shkak se janë të martuara me ne. Vajzat nuk mund të përfitojnë nga pasuria e babait sepse do të martohen dhe do të gëzojnë pasurinë e burrit.



Trashëgimia duhet t'i lihet dhe të trashëgohet vetëm meshkujve të familjes dhe nuk ka asnjë diskutim!

Ky mentalitet është po kaq i rrënjosur dhe evident edhe sot në këto zona, e cila pohohet në mënyrë të qartë në të gjitha intervistat dhe bashkëbisedimet me banorët e zonës, përfshirë edhe gratë.

Sipas ligjit gratë kanë të drejta të barabarta për të drejtën pronësore si një nga të drejtat themelore të njeriut dhe duhet të kerkojnë ndarjen e pasurisë në mënyrë të barabartë si tek burri si tek babai.

E drejta pronësore e grave sipas instrumentave ndërkombëtare

Instrumentet ndërkombëtare nënvizojnë se **të drejtat pronësore nuk kanë asnjë ndikim gjinor: ato janë të barabarta për të gjithë.**

Si e tillë, e drejta epronësisë mbi pasuritë e luajtshme apo paluajtshme, mbi tokën, e drejta për strehim etj janë të drejta themelore të njeriut dhe instrumentat ndërkombëtare mësojnë mbi mbrojtjen e të drejtave të grave në pronësi dhe ndalimin e diskriminimit.



Gratë duke njohur mirë ligjet, instrumentat ndërkombëtare që i mbrojnë mbi të drejtën pronësore janë më të fuqizuara jo vetëm në njohjen e të drejtave të tyre pronësore, por edhe në drejtime të tjera të jetës private dhe publike.

Për gratë në kontekstin familjar kjo do të thotë shumë më tepër. Të pasurit e një titulli pronësie mbi një tokë apo mbi një pronë të jep mbrojtje. Një titull pronësie përbën siguri për familjen në kohë të vështira, mund të rrisë pushtetin e negocimit brenda familjes dhe ofron mundësi për pavarësi ekonomike, qoftë dhe për mundësimin e kredive për nisma sipërmarrëse

Pse duhet t'i njohin gratë instrumentat ndërkombëtare?



Së pari, ato e shikojnë të drejtën pronësore si të drejtë themelore të individit.

Së dyti, të drejtat pronësore, shikohen të barabarta për të gjithë dhe nuk lejojnë diskriminimin.

Së treti: marrëveshjet ndërkombëtare janë të ratifikuara në ligj dhe kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë (RSH).

Sipas nenit 116 të Kushtetutës së RSh, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, si akte normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, renditen pas Kushtetutës.

Sipas nenit 122 marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara:

- Janë pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi botohen në Fletoren Zyrtare;
- Kanë karakter të vetëzbatueshëm, përveç rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi kërkon nxjerrjen e një ligji;
- Kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me to.

Në vijim do të rendisim disa instrumenta ndërkombëtare që nënvizojnë rëndësinë që ka e drejta pronësore dhe ndikimin e saj në fuqizimin e gruas në jetën publike dhe private.

DEKLARATA UNIVERSALE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Kjo deklaratë është frymëzuese dhe mbështetëse e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, përfshirë këtu dhe të drejtën pronësore.

Në nenin 17:

1. Gjithkush ka të drejtën të ketë pasuri, si vetëm ashtu edhe në bashkëpronësi me të tjerët.
2. Asnjëri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij”.

Në nenin 25:

“Gjithkush ka të drejtë për një nivel jetese të mjaftueshëm që t’i përgjigjet shëndetit dhe jetës së përshtatshme si të atij personalisht, ashtu edhe të familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, banesën, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale, si edhe të drejtën për të qenë i siguruar në rast sëmundjeje, papunësie, vejanie, pleqërie dhe raste të tjera të humbjeve të mjeteve për jetesë për shkak të rrethanave të pavarura nga vullneti i tij/saj”.

Në këto nene shikojmë që askush nuk mund të diskriminohet apo t’i mohohet e drejta për pronësi. Çdo grua ka të drejta si burrat për të pasur pronë, për të qënë e pavarur ekonomikisht, për të gëzuar, poseduar dhe përdorur pronën e saj, pa u cënuar apo diskriminuar nga askush.

KONVENTA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT (KEDNJ)



Edhe kjo konventë e ratifikuar me ligj është një instrument ndërkombëtar që mëshon në të drejtën e pronës.

Sipas nenit 1, protokollit 1 të KEDNJ:

Mbrojtja e pronës: “Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”.


Neni 5, protokollit KEDNJ:

“Bashkëshortët gëzojnë barazi të drejtash dhe përgjegjësish të karakterit të së drejtës private midis tyre dhe në marrëdhëniet me fëmijët e tyre, në lidhje me martesën, gjatë martesës dhe në rastin e zgjidhjes së saj. Ky nen nuk do t’i ndalojë Shtetet që të marrin masa të nevojshme në interesin e fëmijëve”.

Siç mund të shikojmë konventa thekson që ASKUSH nuk mund të privohet nga e drejta e pronës dhe e gëzimit paqësor mbi të. Përveç kësaj, ndalon diskriminimin midis bashkëshortëve në të drejtën e pronës, madje i “vesh” ata me të njëjtat të drejta dhe detyrime mbi pasurinë e tyre.

KONVENTA PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT NDAJ GRAVE [CEDAW], RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 1769/1993

Kjo konventë që në nenin e 5/a kërkon nga të gjitha shtetet të "marrin masat e përshtatshme për të ndryshuar karakteristikat dhe modelet sociale e kulturore të sjelljes së burrit dhe të gruas, në mënyrë që të arrijnë të zhdukin paragjykimet dhe praktikat zakonore, dhe të gjitha praktikat e tjera që mbështeten në idenë e inferioritetit ose të superioritetit të njërit apo të tjetrit seks, ose në rolet stereotipe të burrit dhe të gruas".



E drejta e pronës mbrohet mbi bazën e disa sistemeve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Legjislacioni vendas: Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës e mbrojnë të drejtën e pronës mbi bazën e ligjeve kushtetuese dhe ligjeve përkatëse. Zakonisht, legjislacioni rregullon kushtet për të patur akses, për të gëzuar dhe për të përdorur pronën.

Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian

Neni 17

1. Kushdo ka të drejtë për të patur, përdorur, disponuar ose për të lënë trashëgimi pronën e tij të fituar në mënyrë të ligjshme. Askush nuk mund të shpronësohet, përveçse për shkak të interesit publik dhe në rastet dhe sipas kushteve të parashikuara me ligj, përkundrejt një kompensimi të drejtë për humbjen që duhet të paguhet brenda një kohe të arsyeshme. Përdorimi i pronës mund të rregullohet me ligj për aq sa kjo është e nevojshme për interesin e përgjithshëm.



